



**KOMUNA SHTIME**



**IMPACT Sh.p.k.**

---

# **PLANI RREGULLUES URBAN SHTIME**

---

## **PROFILI URBAN**

---

## **BAZA LIGJORE**

- 1. LIGJIT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR NR. 2003/14**
- 2. UDHËZIM ADMINISTRATIV- PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR MBI ELEMENTET THEMELORE TË PLANIT RREGULLUES URBAN. Nr. Prot: 02/05.**
- 3. LIGJI I NDËRTIMIT 2004/15**
- 4. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE URBAN.**
- 5. KOMUNA E SHTIMES, DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, KADASTËR DHE GJEODEZI**

## **PËRMBAJTJA**

### **A.Pjesa Tekstuale.....1**

#### **Hyrje**

- Historiku i Shtimes
- Keshilli i eksperteve
- Hartuesit e projektit
- Struktura e drejtorive
- Qëllimi i Planit Rregullues
- Metodatat e përpunimit të projektit
- Karakteristikat themelore të hapësirës urbane

#### **Profili urban**

- 1.Pozita dhe sipërfaqja e hapësirës urbane
2. Hapësira urbane në raport me qytetin
  - 2.1. Zona kontaktuese me zona të tjera urbane
- 3.Kushtet Klimatike
- 4.Karakteristikat Seizmike
- 5.Reliefi
- 6.Karakteristikat Morfologjike
- 7.Kushtet gjeografiko – natyrore
  - 7.1 Karakteristikat gjeologjike – lartësia mbidetare
- 8.Karakteristikat Hidrologjike
- 9.Kronologjia e etapave të ndërtimit
- 10.Analiza e gjendjes ekzistuese
  - 10.1.Destinimi i objekteve
  - 10.2.Kategorizimi i objekteve
  - 10.3.Etazhiteti i objekteve
  - 10.4.Zonat sipas dendësisë së shfrytëzimit të hapësirës

10.5.Trafiku dhe transporti

10.5.1.Rrugët ekzistuese

10.5.2.Ujësjetësi

10.5.3.Kanalizimi

10.5.4.Furnizimi me energji elektrike

10.5.5.Rrjeti i telekomunikacionit

10.5.6.Rrjeti termoenergjetikë

10.6.Gjelbërimi dhe peizazhi ekzistues

11.Institucionet e arsimit

12.Institucionet e kujdesit shëndetësor

13.Trashëgimia kulturo-historike

14.Synimet

15.Konkludime

**B. Pjesa Grafike.....2**

1. Kufiri urban
2. Destinimi i siperfaqeve
3. Objektet ekzistuese
4. Objektet publike
5. Rruget e asfaltuara
6. Rruget me asfalt dhe pa asfalt
7. Rrjeti energjetik - tensioni i larte
8. Rrjeti energjetik - tensioni i ulet
9. Trafostacionet
10. Ndriçimi publik
11. Kanalizimi i ujerave te zeza
12. Kanalizimi atmosferik
13. Telefonia fikse
14. Gjelberimi
15. Komunikacioni
16. Ngastrat kadastrale

## HYRJE

### Historiku

Territori i Shtimes me rrethinë ishte i banuar që nga periudhat e hershme, madje edhe nga parahistoria. Gjurmët e banimit vërehen në lokalitetet e shumta, këtë e dëshmojnë kultura materiale, formë gërmadhash të gjetura në disa vendbanime të kësaj hapësire, si në viset malore ashtu edhe në fusha. Lokalitetet që dëshmojnë lashtësinë janë vendbanimet Petrovë, Legjendas, Vojnovc, Godanc i Epërm, si dhe në vet qytetin e Shtimes dhe kodrat përreth, etj. Lokaliteti në afërsi të Shtimes “Lajthijat” dëshmon për gjurmët e lashta të kohës iliro-romake dhe mesjetare. Të gjitha këto lokalitete duhet të gjurmohen dhe të vihen nën mbrojtje, sepse pa e njohur të kaluarën nuk mund ta planifikojmë të ardhmen.

Edhe në periudhën iliro-romake, nëpër këto territore kalonin rrugë të rëndësishme. Dëshmi për këtë është pjesa e rrugës “vjetër” në luginën e lumit Topillë që lidhte lindjen me perëndimin.

Shtimja si vendbanim përmendet për herë të parë në vitin 1326 me emrin Shtimni, në një diplomë lëshuar për një dubrovnikas, që dëshmon për ekzistencën e pallatit të mbretit S. Deçani. Sipas kartës së Dushanit të vitit 1348, banorët e Shtimes ishin të obliguar të ndajnë një sasi nga prodhimet bujqësore për të. Në regjistrin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455, Shtimja është shënuar si fshat i madh me 109 shtëpi. Në fund të shekullit XIX Shtimja kishte 100 shtëpi. Në vitin 1905 kishte 97 shtëpi. Sipas shënimeve statistikore, në vitin 1913 kishte 1232 banorë. Në regjistrimin e vitit 1921 kishte 153 shtëpi me 1071 banorë.

Për shkak të pozitës së mirë gjeografike, si nyje komunikacioni që lidhte lindjen me perëndimin edhe në periudhën osmane Shtimja kishte numër të konsiderueshëm të punëtorive zejtare, kështu që u bë tërheqëse për banorët e rrethinës së saj. Qysh në vitin 1931 Shtimja, arriti që t'i ketë 25 dyqane zejtare. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, fillon rritja e matur e qytetit dhe popullsisë së këtij vendbanimi. Kjo shihet sipas të dhënave nëpër vite:

Në vitin 1921 Shtimja kishte 1071 banorë.

Në vitin 1948 popullsia u shtua në 2003 banorë.

Në vitin 1971 numri i banorëve arrin shifrën 3866 banorë.

Në vitin 1981 numri i banorëve arriti në 5271 banorë.

Me formimin e komunës së Shtimes në vitin 1988, në kuadër të së cilës hynë 21 vendbanime, u paraqitën kushtet dhe dispozitat reale për një zhvillim të pavarur në bazë të mundësive të shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ekonomike ekzistuese. Niveli i urbanizimit të Shtimes dhe vendbanimeve përreth është ende në nivel të ulët. Kjo pasqyrohet me zhvillimin e pamjaftueshëm ekonomik dhe mungesës së industrisë, rrjetit të dobët rrugor, në vet qytetin dhe, vendbanimet përreth, pastaj,

niveli ulët i pajisjes me infrastrukturë komunale (ujësjellës, kanalizim, etj), ndërtim i shumë njësive banuese dhe biznesi në mënyrë të pa planifikuar, të cilat në të shumtën e rasteve janë pa infrastrukturë përcjellëse urbane.

- **Keshilli i eksperteve**

Adriatik Beqaj  
Ali Ademaj  
Arif Beqaj  
Ekrem Reçica  
Enver Ademi  
Hava Shahini  
Mehdi Salihu  
Naim Zeqiri  
Naser Sahiti  
Rexhep Limani  
Sabri Çerkini

- **Hartuesit e projektit**

"IMPACT" Sh.p.k Shtime

Bujar Haxhiu, i.d.arch  
Nehat Haxhiu, i.d.arch  
Burim Sadiku, arch  
Naim Hysenaj, i.d.arch  
Xhavit Baftiu, gjeodet

- **Struktura e drejtorive**

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME  
DREJTORIA PËR EKONOMI DHE FINANCA  
DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, KADASTËR DHE GJEODEZI  
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE  
DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT  
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM  
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

## Qëllimi i Planit Rregullues

Që nga viti 1999, kushtet zhvillimore për komunën e Shtimes kanë ndryshuar rrënjësisht. Shtimja sot ka rastin të shfrytëzojë me kapacitet të plotë të gjitha mundësitë që i ofrohen nga pozita gjeografike, infrastruktura që i mundëson afërsinë me qytetin e Prishtinës, lokacionin e Aeroportit Ndërkombëtarë „Adem Jashari” kufijve të komunës dhe nyja rrugore Prizren - Shkup që vlerësohen si strategji madhore për zhvillim. Si rezultat i kësaj gjendje, Shtimja tani ka përvojën e kërkesave të shumta të ndërtimit që do ta bënin Shtimen një qender më të organizuar dhe me ndërtime më masive.

Qëllimi i këtij plani është që të organizojë ndërtimet në këtë pjesë qendrore të qytetit që është edhe pjesa identifikuese e Shtimes e cila do të paraprijë në strukturën ndërtimore të mëvonshme të qytetit në përgjithësi. Qëllimet kryesore të Planit Ideor Rregullues Urban të Shtimes janë:

- Zhvillimi i konceptit urban për zonat e banimit dhe për zona me përmbajtje të përzier.
- Zhvillimi i banimit të përshtatshëm për të gjithë banorët e zonës,
- Krijimi i kushteve për biznes në zonat me përmbajtje mikse,
- Zhvillimi i infrastrukturës sociale dhe teknike në këtë zonë,
- Krijimi i ambientit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm,
- Shfrytëzimi i potencialeve natyrore në këtë zonë duke krijuar një sistem të parqeve dhe sipërfaqeve të lira për rekreacion
- Minimizimi i ndotjes së ajrit duke promovuar shfrytëzimin e burimeve alternative të energjisë,
- Krijimi i një sistemi të trafikut efektiv me kapacitet të lartë,
- Planifikimi i rrugëve dhe udhëkryqeve të kësaj zone me rrugë dhe sheshe atraktive urbane.

Programi është bazuar në profilin urban dhe qëllimet, si dhe PZHK 2008-2020.

- Zhvillimi hapësinor urban duhet të drejtohet në drejtim të zonave të banimit me përshkrim të ndryshëm, standard ndërtimorë, densitet, lartësi dhe madhësi të ndërtimeve, në mënyrë që të plotësojë kërkesat e grupeve me të ardhura dhe stile të ndryshme të jetës.
  - Zhvillimi i një zonë të kësaj madhësie mund të zgjasë 10-15 vjet, dhe gjatë kësaj kohe nevojat dhe kërkesat e kësaj zone mund të ndryshojnë, prandaj është e rëndësishme që të krijohet një strukturë stabile urbane e cila është fleksibile dhe mund të reagojë në ndryshimet gjatë kohës së zhvillimit.
  - Zhvillimi i infrastrukturës sociale duhet të ketë fleksibilitetin e duhur për të reaguar në kërkesat e ndryshimeve.
- Qyteti gjithashtu duhet të funksionojë si qendër e zhvillimeve të banimit në komunë. Kjo nënkupton plotësimin e nevojës për banim në Shtime si rezultat i migrimit përbrenda apo jashtë komunës.



Në qytetin e Shtimes duhet të ofrohen një numër i madh shërbimesh publike dhe jo-publike.

Sektori i tregtisë duhet të përkrahet në mënyrë që të mund të sigurohet një numër i madh i produkteve të nevojshme afatshkurte, afatmesme dhe afatgjate. Po ashtu duhet të mundësohet ofrimi i pajisjeve shëndetësore, mësimore, kulturore dhe rekreative me rëndësi të madhe për komunën të cilat do të përqendrohen në qytetin e Shtimes.

- Sistem i trafikut dhe transportit, nuk duhet t'u shërbej vetëm banorëve të ardhshëm të zonës , por duhet të ndikojë në një qasjeje më të mirë për tërë zonën urbane të qytetit.
- Rrugët ne këtë zonë do te zhvillohen ne bazë te kërkesave teknike të trafikut dhe gjithashtu do të jenë rrugë atraktive të qytetit. Do të krijohen edhe infrastruktura te tjera teknike te cilat janë te lidhura me zhvillimin e mëtutjeshëm te zonave përreth.
- Krijimi i parqeve dhe sipërfaqeve të hapura për rekreacion.

### **Metodat e përpunimit të projektit**

Janë shfrytëzuar metodat që vijojnë:

1. Analiza e gjendjes ekzistuese
2. Anketimi
3. Hartimi i tezave programore dhe harmonizimi i tyre
4. Metodat e parashikimit dhe planifikimit
5. Gjetja e opcioneve ne kuadër të kornizës programore

**Analiza e gjendjes ekzistuese** - Analiza e gjendjes ekzistuese si dhe inventarizimi i fondit ekzistues ndërtimor është imponuar si nevojë që të fitohet fotografia reale e situatës së tanishme në terren. Me analizë janë siguruar të dhënat për:

- Shfrytëzimin e tanishëm të sipërfaqeve
- Numri dhe kualiteti i objekteve
- Tipi i objekteve sipas përmbajtjeve
- Materialit të ndërtimit, etj.

**Tezat programore** - rrjedhin si rezultat i kërkesave të caktuara të bazuara në Planin Zhvillimor Urban të Shtimes (2008 -2020).

## Karakteristikat themelore të hapësirës urbane

### 1.Pozita gjeografike dhe sipërfaqja e hapësirës urbane

Komuna e Shtimes ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Neper territorin e komunës, ne afersi te qendres se qytetit, rrjedh lumi Shtimjanka. Gjithashtu, kjo komunë gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë të qendrave më të mëdha të rajonit si:

Shtime – Prishtinë	28 km
Shtime – Mitrovicë	68 km
Shtime – Prizren	42 km
Shtime – Gjakovë	78 km
Shtime – Pejë	88 km
Shtime – Podujevë	58 km
Shtime – Ferizaj	13 km
Shtime – Gjilan	44 km
Shtime - Aeroport	22 km

Territori i komunës së Shtimes ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor e posaqerisht te atij ajror meqenëse aeroporti gjendet vetem 22 km nga qendra e Shtimes. Kjo pozitë e territorit të komunës, si dhe e vetë qytetit Shtime, paraqet rrethanë mjaft të përshtatshme për zhvillimin e mëtejme të komunës.

Territori i Komunës së Shtimes kufizohet me komunat :

- Lipjanit
- Ferizajt dhe
- Suharekes.

Qendra e qytetit ka pozitë qendrore që formon unazën kryesore dhe krijon lidhje të drejtpërdrejtë me lagjet tjera të qytetit. Shtimja ka konfiguracion të përshtatshëm dhe mjaft të mirë të terrenit duke krijuar ndërlidhje me Zonën e re Ndërtimore nga me tutje zgjerohen aktivitetet tjera rëndësishme te cilat mundesojnë ndërlidhje me rajonin.

## 2.KUSHTET KLIMATIKE

Rajoni i Komunës së Shtimes ka klimë të mesme kontinentale me dimëra relativisht të butë dhe verëra mesatarisht të nxehta .Temperatura mesatare vjetore është 10.5 °C , temperatura e përgjithshme vjetore është 3 °C. Muaji më i ftohtë është Janari me - 9 °C ndërsa muaji më i ngrohtë është Korriku me 20.4 °C. Periudha pa ngrica mesatarisht është 186 ditë. Sasia mesatare e të reshurave në këtë rajon është rreth 647 mm, ndërsa gjatë muajit prill - shtator rreth 309 mm. Mungesa e të reshurave gjate periudhes se thatesise eshte perafersisht 350 mm (3500 m<sup>3</sup>/ ha) . Mesatarja vjetore relative e lagështisë së ajrit është 78.7 % ndërsa ajo në sezonin e vegjetacionit është 70% që këtë rajon e bën te klasifikohet ne vend me lagështi mesatare. Insulacioni gjatë vitit është 2.153 orë ndërsa në sezonin e vegjetacionit 1.523 orë. Vranësirat mesatare vjetore të këtij rajoni janë 52 % dhe 41 % (sez.vegj.) Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 1.3 m/s me erën më të fortë të drejtimt jug – perëndim dhe veri – perëndim është 2.8 m/s.

## 3.KARAKTERISTIKAT SEIZMIKE

Sipas të dhënave të mëhershme Shtimja dhe rajoni më i gjerë dhe ndodhet në zonën e tetë seizmike që duhet të merret parasysh gjatë zhvillimit të mëtejme të vendbanimeve.

## 4.RELIEVI

Karakteristikat pedologjike

Tipet më të përfaqësuara të tokave në teritorin e Komunës së Shtimes janë smonicat me më tepër se 25.24 % të cilat me përjashtim të smonicave të eroduara sipas cilësive të veta dhe karakteristikave prodhuese janë toka mjaft të mira, të thella, kryesisht të përbërjes së argjilit të pasura me humus dhe Kalium aktiv. Pjesët në të cilat janë të koncentruara vendbanimet janë toka aluviale. Në perëndim dhe veri të vendbanimeve janë zonat që përmbajnë tokat të tipit smonicë. Në verilindje të vendbanimit janë pjesët me smonicë jokarbonate. Të gjitha tokat i përkasin klasës së bonitetit II, III dhe IV.

## 5.KARAKTERISTIKAT MORFOLOGJIKE

Nga analiza e sipërfaqeve të relievit të teritorit të Shtimes, pjesa më e madhe janë rrafshira, ne perendim dhe ne jug kemi terren te pjerret.

## 6.KUSHTET GJEOGRAFIKO – NATYRORE KARAKTERISTIKAT GJEOLGJIKE – LARTËSIA MBIDETARE

Rajoni i Komunës së Shtimes gjendet në lartësinë mbidetare mbi 570 m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshhtë qe do të thotë deri në 600 m të lartësisë mbidetare të cilat njëherit janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore. Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjindet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera.

## 7.KARAKTERISTIKAT HIDROLOGJIKE

Në pikëpamjen morfologjike teritori I Komunës së Shtimes mund të ndahet në tri forma themelore karakteristike të terrenit:

- gjerësia mesatare e rrafshit të cekur është 4 km sipas gjatësisë ramja është 0.8 % ndërsa tërthorazi është 0.5 %,
- zona kalimtare përfshin pjesët periferike të zonës së parë e cila karakterizohet me pjerrtësi më të vogël të terrenit,
- zona e tretë është sipas madhësisë si dy të mëparmet me relief të shprehur dhe me pjerrtësi më të madhe dhe si e tillë është klasifikuar në terrenin e bregut të lumit.

Teritori i Shtimes në tërësi i takon derdhjes së lumit Shtimjanka dhe ate rrjedhës së mesme. Rrjeti hidrografik i kësaj rrjedhe të lumit Shtimjanka është i zhvilluar në degët më të rëndësishme të saj.

### 8.Hapësira urbane në raport me qytetin

Tërësia hapësinore e qendrës përfshin sipërfaqen rreth 15 ha që funksionon si bërthamë e qytetit në të cilën janë të koncentruara rrugët: rruga “Tiranes” që krijon ndërlidhje, si arterie e rëndësishme për zhvillim, në veri rruga “Prishtines”, në Indje rruga e Ferizajt.

#### 8.1.Zona kontaktuese me zona te tjera urbane

Zona qendrore është pjesa më e rëndësishme – bërthama e qytetit, që siguron hapësirë për funksionet kryesore që kryhen në qendër të qytetit si: tregti, biznes, shërbime sociale dhe kulturore, aktivitete të vogla komerciale etj.

Zona e përzier e rrethon qendrën. Kjo siguron hapësirë për banim dhe aktivitete jo-trazuese komerciale si: tregti, aktivitete jo komerciale, biznesore, kulturore, sociale. Objektet mund të jenë në lartësi deri në P+4 kate.

Për ta forcuar brendinë e qytetit si lokacion, shumica e rrugëve në qendër të qytetit kufizohen me hapësira komerciale. Në këtë zonë, kati përdhësë duhet të përdoret për tregti, aktivitete komerciale dhe biznes. Koncepti i qarkullimit me një unazë qendrore mundëson mbylljen e një rruge pa e penguar lëvizjen e lirë të qarkullimit në brendi të qytetit.

### 9.Kronologjia e etapave të ndërtimit

Deri në vitin 1999, tendencat demografike në këtë hapësirë urbane nuk ishin të theksuara, por ishin në suaza të realizimit të projektit detal urbanistik të viteve të më hershme. Treguesit demografik dhe treguesit e tjerë në periudhën e pas luftës (1999

-2008) janë në rritje. Infrastruktura teknike primare ka pësuar si nga aspekti kohor poashtu edhe nga faktori njeri. Prandaj si e tillë ajo ka nevojë për një intervenim sa më të ngutshëm dhe të shpejtë. Zgjidhjet individuale dhe pa plan, kanë shkaktuar degradim të kësaj hapësire urbane, me çka është shkaktuar një ndotje e konsiderueshme e ambientit dhe një dezurbanizim të pjesës më vitale dhe pjesës identifikuese të qytetit të Shtimes.

## **10. Analiza e gjendjes ekzistuese**

Qendra e qytetit është e dominuar nga banimi i kombinuar me infrastrukturën e nevojshme. Janë të koncentruara objektet publike si: Administrata Komunale, Stacioni Policor, Posta, Shkolla Fillore, si dhe objektet tjera të karakterit të përkohshëm të cilat janë në funksion të shërbimeve publike për nevojat komerciale dhe shërbime të tjera.

Qendra e qytetit ka përmbajtje të kombinuar: të banimit, objekte publike dhe përmbajtje të tjera.

Zona e ndërtuar nuk është aq e dendur me ndërtime. Të gjitha këto ndërtime kanë lidhje legale me rrjetin e infrastrukturës publike siq është uji i pijshëm, kanalizimi, telefonia dhe energjia elektrike.

Shumica e veprimtarive qendrore të Shtimes janë koncentruar në qendër të qytetit, se bashku me institucionet publike si ndërtesa e Komunës, Posta dhe objekte të ndryshme afariste.

### **10.1. Destinimi i objekteve**

Në tërësi zona e Qendrës së Qytetit ka një përmbajtje multifunksionale, që formon strukturën urbane të qytetit, me përmbajtje për banim, afarizem dhe publike dhe atë me etazhitet P, P+1, P+2, P+3 dhe P+4.

Tërësia urbane karakterizohet me objektet ekzistuese, ndërsa pas vitit 1999 ndërtime të reja kryesisht janë koncentruar si në pjesën e qendrës poashtu në të gjithë pjesët tjera të qytetit kryesisht banim ndërsa në brendi karakterizohet ndërtimi i objekteve afariste të ndërtuara pa leje në hapësira të cilat nuk plotësojnë kushtet urbane dhe kryesisht llogariten si objekte të karakterit të përkohshëm me etazhitet P

#### **Rrugët:**

1. Rruga "Tiranes"
2. Rruga "Prishtines"
3. Rruga "Komandant Kumanova"
4. Rruga "Ahmet Shtimja"

5. Rruga "William Walker"
6. Rruga "12 Qershori"
7. Rruga "Skender Salihaj"
8. Rruga "Jete Hasani"
9. Rruga "Ahmet Kaçiku"
10. Rruga "14 Dhjetori"

Sheshet:

- "Sheshi i UÇK-së"
- "Sheshi i Dëshmorëve"

## **10.2. Kategorizimi i objekteve**

Objektet në hapësirën urbane u analizuan sipas kategorizimit të përfundimit dhe gjendjes. Kategorizimet që u përdorën janë si vijon:

- Objekt i mirë - objekt i përfunduar komplet dhe në gjendje të mirë,
- Objekt i mesëm - objekt i përfunduar komplet por jo në gjendje të mirë,
- Objekt i dobët - objekt i përfunduar komplet por në gjendje shumë të keqe

Një pjesë e objekteve që janë ndërtuar pas luftës dhe janë ndërtuar pa leje , pa ndonjë plan dhe me materiale të përkohshme të cilat edhe përbëjnë një sipërfaqe të madhe të ndërtimeve në qytet që kryesisht janë objekte njëkatëshe .Këto objekte janë ndërtuar edhe jashtë pronave private duke i shfrytëzuar jo ligjrisht hapësirat publike ,qka kjo shkakton edhe revoltë te qytetarët .

## **10.3. Etazhiteti i objekteve**

Etazhiteti i objekte në qendër përkufizohet me ndërtime kryesisht me P+4 në ndërtimet individuale ,ndërsa sa i përket ndërtimeve individuale janë kryesisht ndërtime të ulta të bëra para luftes ,ndërsa ato private pas luftes janë me etazhitet P+4 duke tentuar që etazhat e nënkulmit ti shfrytëzojnë pa leje përkatëse .

## **10.4. Zonat sipas dendësisë së shfrytëzimit të hapësirës**

Ndarja do të bëhet në bazë të blloqeve urbanistike.

## 10.5. Trafiku dhe transporti

Transporti në veçanti dhe komunikacioni në tërësi është parakusht për zhvillimin ekonomik dhe social të një territori. Komuna e Shtimes karakterizohet vetëm me transport rrugor i cili përshkohet prej dy rrugëve magjistrale dhe dy rrugëve regjionale si dhe rrugë të tjera lokale.

Rrugët magjistrale janë: rruga Prishtinë-Prizren (M25) dhe rruga Shtime-Ferizaj (M25.3), kurse rrugët regjionale janë rruga Carralevë-Komoran (R102) dhe rruga Gjurkovc-Koshare (R207). Përgjatë këtyre akseve rrugore zhvillohet transporti ndër-urban dhe kryesisht është i mbuluar nga kompanitë regjionale të transportit publik si të, Prishtinës, Prizrenit dhe Ferizajt, si dhe kompani të tjera lokale. Qyteti i Shtimes edhe pse është kryeqendër komunale nuk ka stacion të autobusëve.

Nga të gjitha rrugët që shtrihen në territorin e komunës së Shtimes 66.32% e tyre janë rrugë lokale dhe rrugë sekondare të qytetit, që d.m.th se të gjitha këto rrugë me gjatësi prej 66.2 km janë nën menaxhimin e qeverisë lokale të Shtimes. Kjo gjendje është barrë e madhe e qeverisë lokale të Shtimes. Qyteti i Shtimes nuk disponon me transport urban dhe arsyeja e mungesës së transportit urban shpjegohet me faktin që prej qendrës së qytetit, gati i gjithë qyteti mbulohet me një rreze prej 1000m.

## 10.6. Rrugët ekzistuese

1. Rruga "Tiranes"
2. Rruga "Prishtines"
3. Rruga "Komandant Kumanova"
4. Rruga "Ahmet Shtimja"
5. Rruga "William Walker"
6. Rruga "12 Qershori"
7. Rruga "Skender Salihaj"
8. Rruga "Jete Hasani"
9. Rruga "Ahmet Kaçiku"
10. Rruga "14 Dhjetori"

## 10.7.Ujësjiellësi

Ujësjiellësi në Shtime është ndërtuar ne vitin 2000-2002 nga kryqi i kuq Gjerman dhe ka kushtuar përafërsisht 1.5 milion euro. Ky sistem është ne funksionon prej muajit shkurt te vitit 2003 dhe është njësi operative e hidro-kompanisë regjionale “Prishtina” në Prishtine.

Përveç ujësjiellësit të qytetit, njësia operative, Ujësjiellësi në Shtime menaxhon edhe ujësjiellësin lokal të fshatrave të rrafshit, i cili furnizon fshatrat: Rashincë, Davidovc, Gllavicë, Muzeqinë, Vojnoc dhe Gjerkoc. Në komune funksionojnë edhe sistemi lokal i Carralevës dhe sistemi i Rancit te cilët nuk menaxhohen nga njësia operative ne Shtime.

Komuna e Shtimes ka një rrjetë shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 15 vendbanime ose 71.43% (komuna kadastrale), derisa vetëm 6 vendbanime ose 28.57% (komuna kadastrale) nuk kanë qasje në rrjetën e furnizimit me ujë të pijes. Ky rrjet furnizohet nga tri lokacione të ndryshme me gjithsej 8 puse dhe burime për nxjerrjen e ujit, tri sisteme të pompimit dhe 6 rezervar me kapacitete të ndryshme:

1. Lokacioni i Shtimes
2. Lokacioni i Rashincës
3. Lokacioni Caralevës dhe
4. Lokacioni Lagja e Pajtimit

Perafersisht 97.55 % e popullatës së Shtimes kanë qasje në sistemin e ujësjiellësit kolektiv, derisa vetëm 2.45% e popullatës nuk kanë qasje në këtë sistem.

**Sistemi i ujësjiellësit në Shtime** - merr ujin nga 5 (1 nuk është në funksion) puse në thellësi 40m, shpime këto të cilat ndodhen në vendin e quajtur “Bare”, në drejtim të Rashincës. Këto shpimet janë në largësi prej 60-120m nga lumi Shtimjanja. Kapaciteti i puseve është rreth **Q=40 l/s** (10-11 l/s për secilin pus). Uji nga puset thithet me sistem të pompimit dhe hedhet në Komorën përmbledhës prej nga përcjellët në tre rezervuarët shpërndarës:

- |    |   |           |                     |
|----|---|-----------|---------------------|
| 1. | rezervuari te shkolla e mesme “Naim Frasheri” | kapacitet | 500m <sup>3</sup>   |
| 2. | rezervuari te “Pishat” Petroviq               | kapacitet | 50m <sup>3</sup>    |
| 3. | rezervuari te “Kodra e gështenjave”           | kapacitet | 700m <sup>3</sup> . |

Uji dezinfektohet në rezervuarin akumulues të sistemit të pompimit në stacionin e klorit në bazë standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore. Gjatësia e rrjeti të ujësjiellësit është 24 km, tubacion te ri nga PE (polietileni) me diametër Ø 50mm deri Ø 250mm.



**Puset për furnizim me ujë të pijshëm** -Ky sistem furnizon me ujë qytetin e Shtimes dhe 6 fshatra të Komunës: Petrovë të cilën e mbulon 50%, Reçak, 50% Legjendas, 10% Lagjja e Pajtimit, 50% Godanci i ulët dhe 50% Godanci i Epërm. Sistemi i qytetit furnizon me ujë rreth 9000 banor dhe mbulon 98% te qytetit. Janë te regjistruar 2283 konsumator, prej të cilëve 2248 amvisni dhe 40 institucione (11 shkolla, 10 administrate komunale, 2 ambulanca, 17 institucione tjera). Shkalla e inkasimit për vitin 2008 është 60% te faturimit. Edhe pse rrjeti është i ri regjistrohen në mesatare vjetore rreth 30% humbje nga prodhimi i përgjithshëm prej 1 milion m<sup>3</sup> (nga dy sistemet). Mesatarja e harxhimit të ujit për kokë banori është 180-200 litra në ditë. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Faktorët kryesor që ndikojnë në shkallën relativisht të lartë të humbjeve vlerësohet të jenë: rrjeti i dëmtuar i ujësjellësit, kyçësit ilegal, mos-matja. Përkundër furnizimit 24/h, gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat kritike të sistemit ,(zonat me humbje) ku aplikohen ndërprerje disa orë në furnizim. Cilësia e ujit për pije nga ujësjellësi i Shtimes kontrollohet nga IKSHPK-Prishtinë që nga fillimi i funksionimit të ujësjellësit. Frekuenca dhe numri i pikave të mostrimit përcaktohet në përputhshmëri me standardet e parapara me IA 2/99 UNMIK.

Nga Grafiku vërehet trendi pozitiv i përmirësimit të cilësisë së ujit për pije neper vite. Që nga fillimi i funksionimit të ujësjellësit, nuk është tejkaluar kufiri i lejuar prej 10% sipas standardeve te OBSH-se për mesataren vjetore të pa përshtatshmërisë bakterore.

### **Ujësjellësi i fshatrave të rrafshit - Rashincë**

Ujësjellësi për fshatrat e rrafshit i quajtur “Sistemi i Rashincës” furnizon vendbanimet: Davidovc, Rashincë, Muzeqinë, Vojnovc, Gjurkovc dhe Gllavicë, me gjithsej 7616/b ose 22.53 % e popullatës së Shtimes.. Uji i këtij sistemi merret nga dy puse me thellësi 36m dhe kapacitet 20 l/s të cilat ndodhen në vendin e quajtur kodra e Rashincës. Nga pusët, uji përcjellët me sistem të pompave në rezervuarin qendror me kapacitet 250m<sup>3</sup> dhe , shpërndahet me gravitacion në rrjetin shpërndarës. Rrjeti i ujësjellësit është i gjatë 30 km me tubacione të PE (polietilen) me dimensione Ø50mm deri Ø 225mm.

### **Ujësjellësi i fshatrave malore – Caralevë**

Ky ujësjellës furnizon vendbanimet: Caralevë, Belinc, Pjetërshticë dhe Zborc, me gjithsej 5903/b ose 17.46% e popullatës së Shtimes. Uji i këtij sistemi merret nga burimi sipërfaqësor, me kapacitet 20 l/s. Burimi i ujit respektivisht kaptazha e burimit të ujit nuk ka mbrojtje sanitare, për shkak të dëmtimeve, ka mundësi të komunikimit me ujë sipërfaqësor, posaçërisht gjatë sezoneve me reshje të mëdha, si dhe, ka qasje të lirë të njerëzve dhe shtazëve. Nuk ka sistem të klorizimit dhe, nuk është në menaxhim të njësisë operative të ujësjellësit. Nga burimi ujit përcjellët me sistem të pompave në rezervuarin akumulues V= 30m<sup>3</sup> dhe, pastaj në rezervuarin qendror

$V=250m^3$ . Rrjeti i ujësjellësit është i gjatë 16km tubacione të polietilenit me profile Ø50mm deri Ø 180mm. Ky sistem relativisht i ri është lëshuar në punë në dhjetor 2003, ka pas vështirësi në funksionim, për shkak të dëmtimit të kaptazhit, sistemit të pompave, si dhe, mos funksionimi i klorinatorit, gjë që reflektohet në cilësi të ujit.

### **Furnizimi në vendbanimet rurale**

Pjesa e popullatës, e cila nuk është e kyçur në ujësjellës furnizohen me ujë nga puset individuale të cilët janë të cektë dhe të pambrojtur. Këto puse të ndërtuar pa standarde higjienike për ujin e pijshëm, pa izolim sipërfaqësor dhe nëntokësor me thellësia 4-5m dhe shtyllë ujore 2-3m, kategorizohen në puse me ujë të dyshimtë penga cilësia. Gjatë sezoneve të shkrirjes së bores dhe shirave me intensitet të lartë, uji mbërrin lartësi maksimale 4m. Kjo flet se uji në puse është sipërfaqësor me mundësi të ndotjes dhe keqësimin e cilësisë së ujit për pije. Shumica e tyre kanë hidrofor, por pa ventil të sigurisë. Mungesa e ventilit e mundëson futjen e ujit të kontaminuar në sistemin e ujësjellësit dhe ndotjen e sistemit në tërësi. Nga aspekti shëndetësor këto puse janë faktor rreziku permanent dhe e rëndojnë situatën epidemiologjike. ISHP Ferizaj me qëllim të përcjelljes së cilësisë së ujit të pijshëm në vendbanime të cilat nuk janë të kyçura në ujësjellës gjatë vitit 2002-2008 ka bërë mostrimin dhe testimin e ujit për pije, kryesisht nga puset e ambulancave dhe shkollave, si dhe përcaktimin e rrezikut të ndotjes së tyre. Rezultatet flasin për nivel të lartë të kontaminimit:

- 26% të mostrave rezultonin me kontaminim bakterorë,
- 21% të mostrave kanë vlera më të larta të Nitriteve, Nitrateve, Amoniakut
- 53% të mostrave nuk janë ujëra të pijshëm

Bazuar në rezultatet e përcaktimit të rrezikshmërisë të ndotjes së puseve, gjatë viteve 2002-2008, 10% të tyre kanë rrezik shumë të lartë të kontaminimit, 60% rrezik të lartë dhe 30% kanë rrezik të mesëm të kontaminimit.

### **10.8.Kanalizimi**

Në komunën e Shtimes është funksional qysh para luftës së vitit 1999, por edhe sot, është shumë pak i zhvilluar, përkatësisht ky sistem është i shtrirë vetëm në dy vendbanime (komuna kadastrale) të komunës të cilat përbejnë 9.52% të vendbanimeve të komunës. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në sistemin e kanalizimit kolektiv janë:

- Zona urbane e Shtimes me gjithsejtë 9100/b ose 26.29% e popullsisë së komunës
- Davidoci me 718/b ose 2.12% e popullsisë së komunës.

Gjatësia e rrjetës së kanalizimit në zonën urbane të Shtimes është 14.54 km, ndërsa ajo në vendbanimin e Davidocit është 1.76km. Gypa e sistemit të vjetër të kanalizimit janë nga azbesti, përderisa rrjeti i ri ka përbërje betoni dhe PVC, me kapacitet - Ø200, Ø800 dhe Ø1000mm. Sistemi i ujërave të zeza dhe, atyre atmosferike është i përbashkët, përveç atyre të rrugës Tirana në qendrën e qytetit, ku janë të ndara në një gjatësi prej 400m. Të gjitha ujërat e zeza të kanalizimeve në këto dy vendbanime derdhen në tri lokacione të ndryshme në shtratin e lumit Shtimjanja. Pjesa jugore e kanalizimit në zonën urbane i derdh ujërat e zeza rreth 500m, mbi lokacionin e puseve që shfrytëzohen për ujë të pijes, derisa pjesa tjetër e zonës urbane dhe vendbanimi i Davidocit i derdhen ujërat e zeza 200, e më tepër metra nën këto puse. Vetëm 9818/b ose 29.05% e popullsisë së komunës kanë qasje në rrjetën e kanalizimit kolektiv, kryesisht zonë urbane dhe 70.95% e popullatës së komunës nuk kanë qasje në rrjetën e kanalizimit, por ujërat e zeza i derdhen në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në vendbanimet ku jetojnë, përkatësisht në shtratin e përroskave dhe lumenjve.

**Menaxhimi i sistemit të kanalizimit** – është kompetencë e kompanisë regjionale të mbeturinave “PASTERTIA” Ferizaj, njësia operative Shtime. Kjo njësi e menaxhon vetëm sistemin e kanalizimit të zonës urbane të Shtimes, derisa sistemi i kanalizimit në Davidocit është jashtë menaxhimit.

Shfrytëzues të këtij shërbimi në zonën urbane janë gjithsej:

- Amvisëri – 616 E. Familjare
- Institucione – 11 (2 shkolla, QKMF, PTK dhe Administrata e KK) dhe
- Biznese – 235 lokale afariste

### **10.9.Furnizimi me energji elektrike**

Pozita gjeografike e komunës i mundëson edhe një rrjet të rëndësishëm, të furnizimit me energji elektrike. Përveç linjave të furnizimit me energji elektrike me kapacitet 35kv, të cilat vijnë nga dy drejtime, në territorin e komunës kalon edhe linja transite e tensionit të lartë 110KV Bibaj, Shirok-Prizren. Kjo linje shfrytëzohet nganjëherë nga komuna e Shtimes dhe anasjelltas, varësisht prej kërkesës për shfrytëzim, që karakterizohen si linja nacionale që e lidhin Ferizajn me Suharekën dhe ka gjatësi prej 11.76 km që kalon në territorin e komunës. Furnizimi i qytetarëve të Shtimes me energji elektrike, bëhet nëpërmjet të linjës së Lypjanit me kapacitet prej **35KV** deri tek trafo-stacionit kryesor, i cili gjendet në komunën kadastrale të Shtimes dhe ka gjatësi prej 5.35 km. Shtrirja e rrjetës energjetike të komunës nga stacioni kryesor deri tek shfrytëzuesit në tërë territorin e komunës bëhet në pesë drejtime:

1. Drejtimi i Rashincës 10 kv
2. Drejtimi i Petrovës 10 kv
3. Drejtimi i Shtimes 10 kv
4. Drejtimi i Carralevës 10 kv dhe
5. Drejtimi i Koshares. 10 kv

Në rrjetën e furnizimit me energji elektrike të komunës sipas drejtimeve të shpërndarjes së shfrytëzuesve, kemi të vendosura gjithsej 86 trafo-stacione të kapaciteteve të ndryshme. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se nga 86 TS funksionale, 22 prej tyre janë individuale, ndërsa 64 të tjera janë kolektive. Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të energjisë (bazuar në orë regjistruese) është 6184 shfrytëzues. Në tabelën në vijim do të paraqesim numrin e përgjithshëm të: TS, statusin e tyre, numrin e shfrytëzuesve dhe numrin e popullsisë, sipas drejtimeve të furnizimit.

Duke u bazuar në përqindjen (%) e furnizimit të popullsisë së komunës me energji elektrike sipas drejtimeve. Drejtimi i Shtimes përfshinë linjën me të rëndësishme të furnizimit me energji elektrike, sepse bënë furnizimin e 40.08% të popullsisë (përfshirë edhe bizneset) së komunës. Më pas vjen drejtimi i Caralevës me 23.37%, drejtimi i Rashincës me 22.53%, drejtimi i Petrovës me 12.54% dhe ai i Koshares me 1.48% të popullsisë. Duhet patjetër të theksohet se drejtimi i Koshares kryesisht i furnizon bizneset me energji elektrike.

a) **Drejtimi i Rashincës 10KV** – si drejtimi i tretë për nga rëndësia e furnizimit të popullsisë (22.53%), furnizohet nga linjat 35 KV dhe ka gjithsejtë 26 trafo-stacione, me 1257 konsumator, prej tyre 8 trafo-stacione janë individuale (kryesisht biznese) dhe 16 trafo-stacione janë për furnizim kolektiv. Klasifikimi i TS sipas kapacitetit është si në vijim: 3 TS kanë kapacitet prej 50KVA, 2 - 100 KVA, 8 - 160 KVA, 9 - 250 KVA, dhe 3 kanë kapacitet prej 400 KVA. Gjatësia e rrjetës së drejtimit të Rashincës është 13.7 km.

b) **Drejtimi i Petrovës 10KV** - është drejtimi i katër për nga rëndësia e furnizimit të popullsisë (12.54%), furnizohet nga linjat 35KV dhe ka gjithsejtë 9 trafo-stacione, me 696 konsumator, të gjitha trafo-stacione janë kolektive. Shpërndarja e TS sipas kapaciteteve është: 1 TS ka kapacitet prej 100 -KVA, 2 - 160 KVA, 5 - 250 KVA dhe 1 TS ka kapacitet 400 KVA. Gjatësia e rrjetës së drejtimit të Petrovës është 8.1 km.

c) **Drejtimi i Shtimes 10KV** - është drejtimi më i rëndësishëm për furnizim të popullsisë me energji elektrike sepse furnizon 41.56%, të totalit të popullsisë së komunës. Ky drejtim furnizohet nga linjat 35KV dhe ka gjithsejtë 11 trafo-stacione me 2179 konsumator. Prej 11 TS, 2 janë individuale dhe 9 janë kolektive. Shikuar nga numri i TS të instaluar, ky drejtim radhitet i treti. Mirëpo nga këndi i numrit të popullsisë dhe kapaciteteve të TS, ky drejtim klasifikohet si drejtimi më i rëndësishëm në komunë. Nga të gjitha trafo-stacione e instaluar 1 TS ka kapacitet prej 160 -KVA, 2 - 250KVA, 2 - 400 KVA dhe 6 TS kanë kapacitet 630 KVA. Gjatësia e rrjetës së drejtimit të Petrovës është 8.1 km.

d) **Drejtimi i Caralevës 10KV** - është drejtimi më të cilin janë të kyç gjithsej 2034 shfrytëzues me gjithsej 33 trafo-stacione prej të cilave 7 janë individuale dhe

26 kolektive. Me këtë linjë të furnizimit kanë qasje 7899/b ose 23.37% e popullatës së komunës. Në këtë linjë janë të kyçur 33 TS me kapacitete të ndryshme, prej të cilave 2 kanë kapacitet 50KVA, 9 – 100KVA, 1 – 160KVA, 10 – 250KVA, 3 – 400KVA dhe 8 trafo-stacione nuk kanë të dhëna për kapacitetet e tyre.

e) **Drejtimi i Koshares 10KV** - shtrihet në pjesën perëndimore të komunës përkatësisht në këtë rrjetë janë të kyçura 7 TS (4 kanë kapacitet 100KVA, 2 – 160KVA dhe 1 është me kapacitet prej 250KVA. Nga këto trafo-stacione shpërndahet energjia elektrike për gjithsej 18 shfrytëzues, kryesisht të sektorit komercial privat.

f) **Ndriçimi Publik** – është evident vetëm në zonën urbane të komunës dhe, ka gjatësi prej 2500m. Rrjetin e sistemit të ndriçimit është i përbërë prej 60 shtyllave metalike dhe është i shpërndarë në qendrën e qytetit (rruga Tirana), rruga e Prishtinës me 30 shtylla metalike, rruga “Komandant Kumanova” me 5 shtylla të betonit dhe 10 të drurit dhe rruga “Smail Gorani” me 27 shtylla të betonit me ndriçim me gjatësi 87

#### 10.10.Rrjeti i telekomunikacionit

**Telefonia Fikse** – Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Shtimes është i lidhur nëpërmjet fibrës optike, i cili i përket linjës së trasesë Ferizaj – Prizren. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së, në Shtime, e cila posedon vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Kapaciteti total i centralit të postës në Shtime është gjithsej 4100 qifte, prej të cilave 2850 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër janë të pa shfrytëzuara.

Telefonia fikse është e shtrirë në nëntë vendbanime me gjithsej 2850 qifte. Vendbanimet në të cilat është i shtrirë rrjeti janë:

Nga tabela mund të shohim se rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Shtimes është i shtrirë në 42.85% të vendbanimeve me gjithsej 65.12% të popullsisë. Megjithatë, është e nevojshme që të përmendim se qasja e popullatës në telefoninë fikse nuk është në nivelin e dëshiruar, sepse shumica e vendbanimeve kanë kyçje të përgjysmuar.

Në kuadër të zonës urbane, përveç qasjeve individuale në rrjetën e telefonisë fikse kemi edhe vendosjen e 10 foltoreve publike të cilat shtrihen në gjashtë lokacione të zonës urbane. Shpërndarja e foltoreve publike sipas lokacioneve në zonë urbane është:

**Telefonia mobile** – në territorin e Shtimes është e mbuluar mjaftë mirë, pothuajse të gjitha vendbanimet e Shtimes, kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil kanë të shpërndara antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i

antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës është:

**Shërbimet Postare** - në komunën e Shtimes shpërndahet në 4 rajone të përcaktuara nga PTK, dhe është i mbuluar komplet territori i komunës. Shpërndarja e postës, sipas ndarjes në rajone është si në vijim:

1. **Rajoni 1** – (Shtime, Davidoc, Rashincë, Gllavicë, Muzeqinë, Vojnoc, Gjurkoc dhe Zborc)
2. **Rajoni 2** – (Iagjja e Pajtimit, Godanci i ulët, Godanci i Epërm dhe Bregu i Zi)
3. **Rajoni 3** – (Reçaku, Petrova, Topilla, Llanishti, Devetaku dhe Legjendas)
4. **Rajoni 4** – (Belinci, Carraleva, Pjetërshtica, Duga, Karaqica dhe Ranca)

**Shërbimet e Internetit** – Ekzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Shtimes. Territori i komunës nuk është i mbuluar plotësisht me shërbime të internetit, kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore dhe disa pjesë të vendbanimeve rurale. Kryesisht interneti në zonat rurale është i shpërndarë në nivel të internet kafe-ve, të cilat ofrojnë shërbime në vendbanime të ndryshme, si dhe kanë qëllime komerciale. Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit në komunën e Shtimes janë:

1. PTK - 521 linja nëpërmjet të telefonisë fikse
2. IPKO – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale) dhe
3. KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale)

**Radiotelevizioni** – Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Shtimes është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Në këtë komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe: Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21 dhe KTV

1. Radio-televizionet lokale – Radio Shtime-e/a, Radio Dukagjini, etj
2. Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore.

Është e rëndësishme të theksohet se rrjeta nacionale e radio-televizioneve nuk është e shtrirë në të gjithë territorin e komunës, përkatësisht stacionet nacionale televizive si, RTK, RTV21, KTV, nuk kanë mbulesë në vendbanimin e Caralevës dhe Belincit, ani pse këto vendbanime paguajnë taksën e imponuar nga RTK, nëpërmjet të faturave të energjisë elektrike.

## 10.12.Gjelbërimi dhe peizazhi ekzistues


Gjelbrimi është i shtrirë për gjatë tërë qytetit dhe atë në shumicën e rasteve kemi prezente florën vendase edhe për qka karakterizohet vet qyteti megjithatë vërehen ndikimet e qytetarëve të papërgjegjshëm në raste të caktuara ku i kanë prerë. Kjo florë e veçant është mjaft e dendur dhe njëkohësisht aromatike në muajt e parë të pranverës qka i jep Shtimes një qendër më ndryshe nga qytetet tjera . Pejsazhi i formuar është mjaft tërheqës mirëpo nuk ka një dukje të mirëfillt urbanistike e

kryesisht me objektet e ndërtuara të cilat janë në kundërshtim me parimet e rregullta dhe kjo e bënë të duket si një pjesë jo e rëndësishme e qytetit . Prandaj në këtë fazë duhet të kihet kujdes me vendosjen e dhe radhitjen e objekteve.

### 11.0.Gjendja sociale në hapësirën urbane sipas anketimit të banorëve


Projeksionet I dhe II tregojnë parashikimet pas vitit 2020. Për këtë periudhë kohore parashihet rritje e mëtutjeshme e popullatës. Projekzioni I është llogaritur në bazë të shkallës së rritjes pre 75%, projekzioni II në bazë të rritjes në 100%.

**Fig. 1: Popullata – e Supozuar**




Poashtu mund të pritët rënie e nr. të anëtarëve të familjes si pasojë e shtimit të paraparë të pasurisë. Kështu projekzioni I është llogaritur në 4 anëtarë për familje, projekzioni II me 3,5 anëtarë për familje.

**Fig. 2: Numri i Familjes – i Supozuar**



Për shkak të rritjes së shkallës së pasurisë në shoqëri, është paraparë hapësira mesatare për person. Projekzioni I bazohet në hapësirën mesatare prej 17,5 metër katrorë për person, projekzioni II bazohet në hapësirën mesatare prej 20m<sup>2</sup> për person.

Hapësira mesatare për person e supozuar



## 12.0. Institucionet e arsimit

### Shkolla fillore “Emin Duraku”

Në qendër ekziston shkolla e arsimit të fillor ku në të vijnë rreth **1108** nxënës dhe ka **57** të punësuar mësues dhe tjerë. Objekti është në gjendje të mirë dhe mund të kontribuojë në rrjedhimin normal të mësimin për këtë zonë.

Qerdhja gjithashtu gjendet në lokacionin e cila është e vendosur në një zonë mjaft të mbrojtur dhe duke iu përshtatur kushteve për këtë objekt .Objekti është njëkatësh dhe është në gjendje të mirë.

## 13.0. Trashëgimia kulturo-historike

Qendra e qytetit është relativisht e re dhe nuk ka ndo një objekt me rëndësi të veçant apo që lidhet me ndonjë ngjarje historike prandaj edhe sanimi i objekteve të vjetra është më i lehtë dhe pa ndonjë studim të veçant.

## 14.0. Synimet

Qendra e qyteteve gjithmonë synon në prirje të aktiviteteve afariste dhe ekonomike te përfaqësimit të qytetit përkatës ,pra edhe qendra e Lipjanit synon një zhvillim më të hovshëm ekonomik si përcakëtues i këti qyteti

## 5.0. Konkludime

Shtimja është një qytet në zhvillim e siper per nga aspekti ekonomik. Arsye per eshte fakti qe kjo komunë gjendet në trekëndëshin ekonomik të paraparë me planin Hapësinor të Kosovës si dhe tangenti i të gjitha rrugëve me rëndësi shtetërore kalojnë në këtë komunë.

Prandaj, duke u bazuar në këtë edhe qendra e këti qyteti do të ketë një influencë të madhe nga këto strategji si bazë e mirë për realizimin e këti projekti. Te gjitha keto mundesi jane premtuese që Shtimja në dekadat e ardhshme të bëhet më shumë si qendër administrative dhe shoqërore ne funksion te qytetarve.